

MAK ALBANIA sh.p.k

Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

Së bashku me Raportin e Audituesit të pavarur

mazars

PËRMBAJTJA:

	FAQE
RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR	
PASQYRAT FINANCIARE:	
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	3
PASQYRA E PERFORMANCËS	4
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	5
PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE	6
SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE	7 – 22

RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR**Për drejtimin dhe ortakun e Shoqërisë Mak ALBANIA sh.p.k****Opinion**

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Shoqërisë **MAK ALBANIA sh.p.k** (Shoqëria), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datën 31 dhjetor 2019, pasqyrën e performancës, pasqyrën e fluksit të mjeteve monetare dhe pasqyrën e ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur në këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më datën 31 dhjetor 2019, performancën e saj financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara në Shqipëri.

Pasiguri materiale të lidhura me vijimësinë

Ju tërheqim vëmendjen përse i përket Shënimit 2.3 në pasqyrat financiare ku tregohet se ka pasiguri në lidhje me vazhdimësinë e njësisë ekonomike në të ardhmen e afërt si pasojë e transferimit të aktivitetit të kryer në nëntor 2018 dhe janar 2019. Këto kushte tregojnë për ekzistencën e një pasigurie materiale e cila mund të hedhë dyshime të rëndësishme mbi aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi. Opinioni ynë nuk është modifikuar në lidhje me këtë çështje.

Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Shoqërisë për të vazhduar aktivitetin e saj në bazë të parimit të vijimësisë, shënimet shpjeguese, si edhe për çështjet që lidhen me vazhdimësinë e aktivitetit të shoqërisë, duke përdorur parimet bazë të vazhdimësisë, përveç rastit kur drejtimi ka për qëllim të likuidojë aktivitetin, ose të ndërpresë aktivitetin operacional, ose nuk ka asnjë alternativë tjetër reale përveçse më lart.

Palët e ngarkuara me qeverisjen janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional gjatë gjithë periudhës së auditimit. Gjithashtu ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, planifikojmë dhe zbatojmë procedurat përkatëse për zbutjen e këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidencë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e mashtrimit është më i lartë se rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e gabimit, për shkak se, mashtrimi mund të përfshijë fshehje të informacionit, falsifikim të informacionit, përvetësime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptueshmëri të atyre kontrolleve të brendshme relevante për procesin e auditimit me qëllim hartimin e procedurave të auditimit në përputhje me rrethanat, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël të kryera si edhe paraqitjen në shënimet shpjeguese përkatëse të bëra nga Drejtimi.
- Shprehemi në lidhje me përshtatshmërinë e parimit të vijimësisë, bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, mbi ekzistencën e një pasigurie materiale mbi aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi aktivitetin e saj. Nëse një pasiguri materiale ekziston, ne duhet të tërheqim vëmendjen në shënimin shpjegues përkatës, nëpërmjet raportit tonë të auditimit, ose nëse shënimet shpjeguese nuk janë të përshtatshme ne duhet të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona jepen mbi bazën e evidencës së auditimit të marrë deri më datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë ndërprerje të aftësisë së Shoqërisë për vijimësi.
- Vlerësojmë paraqitjen, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare dhe të shënimeve shpjeguese dhe në rast se ato përfaqësojnë drejt transaksionet dhe ngjarjet.

Ne komunikojmë me personat të ngarkuar për qeverisjen e Shoqërisë, përveçse çështjeve të tjera, edhe objektin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet kryesore të auditimit, përfshirë çdo mangësi relevante në kontrollin e brendshëm të identifikuar gjatë auditimit tonë.

26 tetor 2020



Rr. Emin Duraku, Pall "Binjaket",
No.5, 1000, Tirana, Albania
phone : +355 42 27 80 15
www.mazars.al , info@ mazars.al

A handwritten signature in blue ink, appearing to read 'Teit Gjini', written over a horizontal line.

Teit Gjini
Auditues Ligjor

MAK ALBANIA shpk

(Vlerat janë në Lek)

**Pasqyra e Pozicionit Financiar
më 31 dhjetor 2019**

	Shënime	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
AKTIVE			
Aktive afatshkurtra			
Mjete monetare	5	4,873,881	10,491,086
Llogari të arkëtueshme tregtare	6	12,406,041	94,743,853
Të tjera llogari të arkëtueshme	7	97,706	378,393
Llogari te arketueshme nga palët e lidhura	8	36,379,883	8,723,379
Parapagime dhe shpenzime të shtyra	9	96,748,840	85,807,784
Totali i aktiveve afatshkurtra		150,506,351	200,144,495
Aktivet afatgjata			
Aktive afatgjata materiale	10	-	1,494,744,731
Totali i aktiveve afatgjata		-	1,494,744,731
Totali i aktiveve		150,506,351	1,694,889,226
DETYRIMET			
Detyrime afatshkurtra			
Llogari të pagueshme tregtare	11	24,928,252	83,926,641
Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura	12	47,507,499	13,747,648
Detyrime tatimore	13	27,895	64,890
Të tjera detyrime	14	39,986,224	35,370,792
Totali i detyrimeve afatshkurtra		112,449,870	133,109,971
Detyrime afatgjata			
Hua afatgjata		-	-
Totali i detyrimeve afatgjata		-	-
Totali i detyrimeve		112,449,870	133,109,971
Kapitali			
Kapitali themeltar		9,703,765,750	11,238,757,236
Fitime të mbartura		(9,676,977,981)	(9,453,487,372)
Fitimi i ushtrimit		11,268,712	(223,490,609)
Totali i kapitalit	15	38,056,481	1,561,779,255
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		150,506,351	1,694,889,226

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 22, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

MAK ALBANIA shpk

(Vlerat janë në Lek)

Pasqyra e Performancës
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	16	34,221,972	291,998,411
Të ardhura të tjera të shfrytëzimit	17	1,568,299	105,142,278
Total të ardhura		35,790,271	397,140,689
Materiale të para dhe të konsumueshme	18	(11,889,203)	(135,560,628)
Shpenzime të personelit	19	(773,242)	(126,301,075)
Shpenzime zhvlerësimi dhe amortizimi	10	(5,861,403)	(222,414,419)
Shpenzime të tjera të shfrytëzimit	20	(8,441,401)	(225,192,337)
Të ardhura dhe shpenzime financiare nga interesi		-	(3,848,060)
Fitim humbje nga kurset e kembimit		2,443,690	92,685,221
Shpenzime financiare	21	2,443,690	88,837,161
Fitimi/humbja para tatimit		11,268,712	(223,490,609)
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	22	-	-
Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin		-	-
Fitimi/humbja e vitit		11,268,712	(223,490,609)
Totali i të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse për vitin		-	-
Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse për vitin		11,268,712	(223,490,609)

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 22, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

MAK ALBANIA shpk

(Vlerat janë në Lek)

Pasqyra e Performancës

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	16	34,221,972	291,998,411
Të ardhura të tjera të shfrytëzimit	17	1,568,299	105,142,278
Total të ardhura		35,790,271	397,140,689
Materiale të para dhe të konsumueshme	18	(11,889,203)	(135,560,628)
Shpenzime të personelit	19	(773,242)	(126,301,075)
Shpenzime zhvlerësimi dhe amortizimi	10	(5,861,403)	(222,414,419)
Shpenzime të tjera të shfrytëzimit	20	(8,441,401)	(225,192,337)
Të ardhura dhe shpenzime financiare nga interesi		-	(3,848,060)
Fitim humbje nga kurset e kembimit		2,443,690	92,685,221
Shpenzime financiare	21	2,443,690	88,837,161
Fitimi/humbja para tatimit		11,268,712	(223,490,609)
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	22	-	-
Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin		-	-
Fitimi/humbja e vitit		11,268,712	(223,490,609)
Totali i të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse për vitin		-	-
Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse për vitin		11,268,712	(223,490,609)

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 22, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

MAK ALBANIA shpk
(Vlerat janë në Lek)

Pasqyra e ndryshimeve në Kapital
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

	Kapitali themeltar	Fitimet e Pashpërndara dhe rezultati i vitit	Totali
Pozicioni financiar më 1 Janar 2018	11,907,024,000	(9,453,487,372)	2,453,536,628
Transferim i aktivitetit	(668,266,764)		(668,266,764)
Fitimi neto për periudhën kontabël		(223,490,609)	(223,490,609)
Rezervat		-	-
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2018	11,238,757,236	(9,676,977,981)	1,561,779,255
Transferim i aktivitetit	(1,534,991,486)		(1,534,991,486)
Fitimi neto për periudhën kontabël		11,268,712	11,268,712
Rezervat		-	-
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2019	9,703,765,750	(9,665,709,269)	38,056,481

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 22, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare

Pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 janë aprovuar nga administratorët dhe janë nënshkruar më _____ 2020 në emër të tyre nga:

Miratoi

MAK ALBANIA shpk

(Vlerat janë në Lek)

Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Flukset e parasë nga aktivitetet operative		
Fitim / Humbja e vitit	11,268,712	(223,490,609)
Rregullimet për shpenzimet jomonetare:		
Zhvlerësimi dhe amortizimi	5,861,403	222,414,419
Shpenzime për interesa	-	1,712,682
Lëvizje në provizione	-	147,031,652
Fitimi operativ përpara ndryshimeve në kapitalin qarkullues	17,130,115	147,668,144
Ndryshimi në kapitalin qarkullues		
Ndryshimi në inventar	-	4,740,879
Ndryshimi në llogari të arkëtueshme dhe të tjera	44,020,939	(225,205,650)
Ndryshimi në llogari të pagueshme dhe të tjera	(20,660,103)	(161,157,280)
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit	40,490,951	(233,953,907)
Interesa të paguara	-	(1,712,682)
Mjetet monetare neto nga aktivitetet operative	40,490,951	(235,666,589)
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit		
Blerje e aktiveve afatgjata materiale	(46,108,156)	-
Asete të transferuara/tranferim biznesi	-	(21,105,237)
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit	(46,108,156)	(21,105,237)
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit		
(Ripagim)/ te hyra nga huate	-	-
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit	-	-
Ndryshimi neto i mjeteve monetare	(5,617,205)	(256,771,826)
Mjetet monetare në fillim të periudhës	10,491,086	267,262,912
Mjetet monetare në fund të periudhës	4,873,881	10,491,086

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 22, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

MAK ALBANIA shpk

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

(Vlerat janë në Lek)

1. Informacion i përgjithshëm

Mak Albania Shpk është krijuar në vitin 1994, me vendim gjykate Nr. 4453, date 25 Maj 1994. Veprimtaria e saj rregullohet sipas dispozitave përkatëse të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" dhe nga statuti i saj.

Shoqëria ka NIPT J61821059A.

Selia e shoqërisë është Sheshi Italia, Ambjenti me Nr. pasurie 7/41, zona kadastrale 8160, Tiranë.

Në datë 05.02.2018 kuotat e shoqërisë janë blerë nga kompania Kastrati Group e cila zoteron 100% të kapitalit të shoqërisë.

Administratori i shoqërisë në datë e lëshimit të pasqyrave është Shefqet Kastrati.

Në datë 20.11.2018 shoqëria transferoi një pjesë të aktivitetit tek shoqëria "Kastrati Hotel and Towers" sh.p.k dhe në janar 2019 transferoi një pjesë tjetër tek shoqëria "Kastrati Residences" shpk.

Aktiviteti i saj gjatë vitit 2019 është kryer nëpërmjet shërbimit të dhënjes së qerave deri në muajin shkurt përveç kontratave me OSCE dhe Vodafone të mbyllur në muajin prill dhe të tjera.

Në 31 dhjetor 2019 shoqëria ka 1 punonjës (2018: 5).

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

2.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKK) dhe ligjin nr.25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

2.2. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3. Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare janë përgatitur në bazë të parimit të vijimësisë. Ka ngjarje të pasigurta në të ardhmen që mund të rezultojnë në pamundësi të njësisë ekonomike për të qenë në gjendje për të vazhduar në biznes në të ardhmen e afërt si pasojë e transferimit të aktivitetit të kryer në nëntor 2018 dhe janar 2019.

2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare (vazhdim)

2.5. Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

2.5.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuara të cilat rezultojnë nga pamundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

2.5.2. Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50%. Në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

MAK ALBANIA shpk

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

(Vlerat janë në Lek)

3. Politikat Kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

3.1. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivët dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Deri më 31 dhjetor 2018, regjistrimet kontabël mbaheshin më vete për çdo divizion. Përveç divizionit të hotelierisë të gjitha divizionet e tjera i mbajnë regjistrimet në USD.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	2019	2018
EUR/LEK	121.77	123.42
USD/LEK	108.64	107.82

3.2. Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivët financiarë çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.2. Instrumentat financiarë (vazhdim)

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizionit për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar njihet me vlerën nominale. Aksionet e zakonshme klasifikohen si kapitale.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.2. Instrumentat financiarë (vazhdim)

Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi që mund të maten në mënyrë të besueshme.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.3. Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar.

Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

3.4. Aktive afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me vlerën e drejtë duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar. Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit.

Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktivit afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

MAK ALBANIA shpk

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

(Vlerat janë në Lek)

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.4. Aktive afatgjata material (vazhdim)

ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

iii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivitetit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivitetet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit.

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin 2019 dhe 2018 është si më poshtë:

Kategoria e aktiveve	Norma e amortizimit %		Metoda e llogaritjes
	2019	2018	
Ndërtesa dhe instalime	5	5	
Makineri e pajisje	20	20	
Mjete transporti	20	20	Mbi Vlerën e mbetur
Mobilje orendi	20	20	
Pajisje elektronike	25	25	

Amortizimi nuk aplikohet për tokën dhe punimet në proces që nuk janë në funksionim.

iv. Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit. Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

3.5 Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësi ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.6 Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivitetit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

Shoqëria ka vetëm qira operative.

3.7 Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

3.8 Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshëm të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2019 është 15% (2018: 15%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlllogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Gjendjet e shtyra tatimore maten me normat tatimore në fuqi ose që konsiderohen në fuqi në fund të periudhës së raportimit, të cilat pritet të zbatohen për periudhën kur diferencat e përkohshme do të anulohen ose humbja tatimore e mbartur do të shfrytëzohet.

Aktivitet tatimore të shtyra për diferencat e përkohshme të zbritshme regjistrohen deri në atë masë që është e mundur që fitimi i tatueshëm në të ardhmen të mund të përdoret për zbritjet në fjalë.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.9 Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

3.10 Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

3.11 Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

3.12 Aktivitet dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

4. Gjykimet dhe vlerësimet kritike të kontabilitetit

Ndërsa situata pandemike COVID-19 ende po evoluon në Shqipëri dhe në mbarë botën, ka pasiguri të lartë mbi shtrirjen e saj në kohën e lëshimit të këtyre pasqyrave financiare. Si pasojë, menaxhimi nuk është në gjendje të vlerësojë me siguri dhe të sigurojë një vlerësim sasior të ndikimit të mundshëm të kësaj pandemie në kompani. Ndërsa masat kufizuese vazhdojnë, volumi i shitjeve, fluksi i parasë, zhvlerësimi i aktiveve afatgjata materiale mund të ndikohen. Sidoqoftë, në datën e këtyre pasqyrave financiare, kompania po operon, vazhdon të përmbushë detyrimet e saj në kohën e duhur dhe për këtë arsye vazhdon të zbatojë parimin e vijimësisë në përgatitjen e pasqyrave financiare.

MAK ALBANIA shpk**Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019**

(Vlerat janë në Lek)

5. Mjete monetare

Mjetet monetare në arkë dhe bankë detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Arka	-	-
Banka	4,873,881	10,491,086
	<u>4,873,881</u>	<u>10,491,086</u>

6. Llogari të arkëtueshme tregtare

Llogaritë e arkëtueshme tregtare më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Llogari të arkëtueshme tregtare	30,224,812	112,562,624
Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme	(17,818,771)	(17,818,771)
	<u>12,406,041</u>	<u>94,743,853</u>

Lëvizjet në zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme:

	<u>31 dhjetor 2019</u>
Gjendja në fillim	17,818,771
Krijimi i provizioneve	-
Rimarrja e provizioneve	-
Gjendja në fund	<u>17,818,771</u>

7. Të tjera llogari të arkëtueshme

Të tjera llogari të arkëtueshme më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Të tjera kërkesa	-	-
TVSH në doganë	97,706	97,706
TVSH e arkëtueshme	-	280,687
	<u>97,706</u>	<u>378,393</u>

MAK ALBANIA shpk**Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019**

(Vlerat janë në Lek)

7. Të tjera llogari të arkëtueshme (vazhdim)

Lëvizjet në zhvlerësimin e kërkesave të tjera janë si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>
Gjendja në fillim	177,390,292
Krijimi i provizioneve	-
Rimarrja e provizioneve	-
Gjendja në fund	<u>177,390,292</u>

8. Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura

Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Kastrati Hotels and Tower	19,116,440	-
Autostar	5,382,008	82,330
Të drejta ndaj ortakëve dhe aksionerëve	10,113,236	8,450,357
Kastrati Residences	1,492,199	-
Albsig sha	-	98,692
Kastrati Construction	276,000	92,000
	<u>36,379,883</u>	<u>8,723,379</u>

9. Parapagime dhe shpenzime të shtyra

Parapagime dhe shpenzimet e shtyra detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Paradhënie për furnitorë	89,695,360	77,203,360
Shpenzime të shtyra	6,161,967	7,712,911
Tatim fitimi	891,513	891,513
	<u>96,748,840</u>	<u>85,807,784</u>

MAK ALBANIA shpk

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbylltur më 31 dhjetor 2019

(Vlerat janë në Lek)

10. Aktive afatgjata materiale

Kosto	Toka	Ndërtesa	Makinieri dhe Pajisje	Mjete transporti	Te tjera AMM	Asete në proces	Totali
Gjendja më 1 janar 2018	113,323,512	7,042,009,452	1,442,854,310	12,476,992	1,044,010,052	10,761,414	9,665,436,732
Shtesa	-	1,423,297	1,982,416	-	17,699,524	-	21,105,237
Asete të transferuara me transferim biznesi	(32,231,401)	(3,995,837,642)	(1,442,854,310)	-	(1,044,010,052)	-	(6,514,933,405)
transferime	-	10,761,414	578,107	-	(578,107)	(10,761,414)	-
Gjendja më 31 dhjetor 2018	81,092,111	3,058,356,521	2,560,523	12,476,992	17,121,417	-	3,171,607,564
Shtesa	46,108,156	-	-	-	-	-	46,108,156
Asete të transferuara/tranferim biznesi	(127,200,267)	(3,058,356,521)	(2,560,523)	(12,476,992)	(17,121,417)	-	(3,217,715,720)
Gjendja më 31 dhjetor 2019	-	-	-	-	-	-	-
Amortizimi i akumuluar							
Gjendja më 1 janar 2018	-	3,586,866,174	1,283,193,624	12,237,994	915,708,293	-	5,798,006,085
Amortizimi i vitit	-	172,757,163	23,949,104	47,800	25,660,352	-	222,414,419
Asete të transferuara me transferim biznesi	-	(2,108,003,390)	(1,305,183,980)	-	(930,370,301)	-	(4,343,557,671)
Gjendja më 31 dhjetor 2018	-	1,651,619,947	1,958,748	12,285,794	10,998,344	-	1,676,862,833
Amortizimi i vitit	-	5,861,403	-	-	-	-	5,861,403
Asete të transferuara/tranferim biznesi	-	(1,657,481,350)	(1,958,748)	(12,285,794)	(10,998,344)	-	(1,682,724,236)
Gjendja më 31 dhjetor 2019	-	-	-	-	-	-	-
Vlera neto kontabël							
Gjendja më 31 dhjetor 2018	81,092,111	1,406,736,574	601,775	191,198	6,123,073	-	1,494,744,731
Gjendja më 31 dhjetor 2019	-	-	-	-	-	-	-

Daljet e asteve gjatë periudhës lidhen me transferimin dhe janë në përputhje me raportin e transferimit të datës 17 nëntor 2019.

MAK ALBANIA shpk**Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019**

(Vlerat janë në Lek)

11. Llogari të pagueshme tregtare

Llogaritë e pagueshme tregtare më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Detyrime për furnitorë	24,928,252	83,926,641
	<u>24,928,252</u>	<u>83,926,641</u>

12. Llogari të pagueshme nga palët e lidhura

Llogaritë e pagueshme nga palët e lidhura më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Kastrati Residences	10,838,679	-
Kastrati Hotels and Tower	-	13,237,861
Autostar albania	-	96,781
Kastrati shpk	-	275,186
Kastrati sha	137,820	137,820
Kastrati Construction	36,531,000	-
	<u>47,507,499</u>	<u>13,747,648</u>

13. Detyrime tatimore

Detyrimet tatimore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Sigurime shoqërore dhe shëndetësore TAP	884	64,890
Tatimi mbi vlerën e shtuar	27,011	-
	<u>27,895</u>	<u>64,890</u>

14. Të tjera detyrime

Të tjera detyrime më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Depozita për garanci	-	6,573,286
Të tjera	-	2,015,366
Financime të tjera (BFI)	39,986,224	26,782,140
	<u>39,986,224</u>	<u>35,370,792</u>

MAK ALBANIA shpk
Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
(Vlerat janë në Lek)

15. Kapitali themeltar

Kapitali i shoqërisë është 9,703,765,750 LEK i zotëruar nga:

	2019	
	%	Kapitali themeltar
Kastrati Group	100	9,703,765,750
	100	9,703,765,790

Në përputhje me raportin e transferimit të datës 17 nëntor 2019, shoqëria transferoi në shoqërinë "Kastrati Residences sh.p.k.", aktive afatgjata materiale. Shuma e kapitalit të transferuar ishte 1,534,991,486 Lek. Ky transferim e uli vlerën e kapitalit nga 11,238,757,236 Lek me 31 dhjetor 2018 në 9,703,765,750 Lek në 31 dhjetor 2019.

16. Të ardhura

Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Të ardhura nga qera zyra	9,518,297	-
Të ardhura nga qera dyqani	8,327,872	-
Të ardhura nga dhomat- te huajt	-	101,445,873
Të ardhura nga dhomat- grupet	-	70,156,369
Të ardhura nga dhoma te tjera	-	499,912
Të ardhura nga qera vilash	-	1,403,728
Të ardhura nga ushqimi	7,785,746	100,021,609
Të ardhura nga ushqimi dhe pijet e perfituara	-	(2,851,672)
Të ardhura nga mirëmbajtja	6,285,208	-
Të ardhura te tjera	2,304,849	-
Të ardhura nga pijet - restoranti	-	21,322,592
	34,221,972	291,998,411

Tabela më poshtë paraqet rakordimin e të ardhurave:

	31 dhjetor 2019
Rakordimi i të ardhurave me FDP-në	
Qarkullim i tatueshëm	35,966,167
Mbyllje paradhënje	(175,896)
Shuma e qarkullimit e korrektuar	35,790,271
Sipas Kontabilitetit	35,790,271
Diferenca	-

MAK ALBANIA shpk
Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
(Vlerat janë në Lek)

17. Të ardhurat e tjera

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit përfshijnë fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit nga aktiviteti tregtar dhe detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>
Të ardhura nga qendra e biznesit	-	80,461,570
Të ardhura të tjera	1,568,299	24,680,708
	<u>1,568,299</u>	<u>105,142,278</u>

18. Materiale të para dhe të konsumueshme

Në këtë zë paraqiten kostoja e mallrave, lëndeve të para dhe shërbimeve të konsumuara që lidhen me veprimtarinë e shfrytëzimit. Materiale të para dhe të konsumueshme detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>
Kosto e Mallrave të shitura	-	39,004,670
Furnitura, nëntrajtime dhe shërbime	11,889,203	96,555,958
	<u>11,889,203</u>	<u>135,560,628</u>

19. Shpenzime personeli

Shpenzimet e personelit detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>
Pagat e personelit	654,263	110,959,775
Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	118,979	15,341,300
	<u>773,242</u>	<u>126,301,075</u>

Numri i punonjësve më 31 dhjetor 2019 është 1 (2018: 5).

MAK ALBANIA shpk
Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
(Vlerat janë në Lek)

20. Shpenzime të tjera

Shpenzimet e tjera detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>
Shpenzime Marketing	-	1,267,705
Shpenzime provizione klient	-	10,999,433
Taksa	3,890,776	11,721,936
Gjoha dhe dëshpërblime	-	147,031,651
Provizione	427,900	-
Shpenzime të tjera	4,122,725	54,171,612
	<u>8,441,401</u>	<u>225,192,337</u>

21. Të ardhura dhe shpenzime financiare

Të ardhurat dhe shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet e interesit dhe rezultatin nga kursi i këmbimit që lidhet me aktivitetin financiar të shoqërise. Ky zë detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>
Fitim nga kursi i këmbimit	3,655,099	95,913,484
Humbje nga kursi i këmbimit	(1,211,409)	(3,228,263)
Te ardhura nga interesat	-	1,343,856
Shpenzime per interesat	-	(5,191,916)
	<u>2,443,690</u>	<u>88,837,161</u>

MAK ALBANIA shpk
Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
 (Vlerat janë në Lek)

22. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin

Përlllogaritja e shpenzimit për tatimin mbi fitimin paraqitet më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Fitim/Humbja Para Tatimit	11,268,712	(223,490,609)
Shpenzimet e pazbritshme	608,747	162,645,234
Zhvlërësime/Provizione	-	10,999,433
Rimarrje provizionesh të tjera	-	(30,358,640)
Gjoha, penalitete	608,747	-
Zhvlërësime për llogari të tjera të arkëtueshme	-	177,390,292
Shpenzime të tjera të panjohura	-	4,614,149
Fitimi i tatueshëm i periudhës ushtrimore	11,877,459	(60,845,376)
Humbje fiskale e mbartur	(11,877,459)	-
Tatim fitimi @15%	-	-
	11,268,712	(223,490,609)

Shoqëria nuk ka njohur ndonjë aktiv tatimor të shtyrë në lidhje me humbjet e mbartura.

23. Angazhime dhe pasiguri

Librat e Shoqërisë nuk janë audituar nga organet tatimore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019. Si rrjedhojë detyrimet tatimore nuk mund të konsiderohen përfundimtare. Detyrime të mundshme që mund të rezultojnë nga një auditim i organeve tatimore nuk mund të maten në mënyrë të besueshme.

24. Ngjarje pas bilancit

Më 11 Mars 2020, Organizata Botërore e Shëndetit e deklaroi koronavirusin (COVID-19) një pandemi. Ndërsa situata është ende duke u zhvilluar në Shqipëri dhe në mbarë botën, ka pasiguri të lartë mbi shtrirjen e saj në kohën e lëshimit të këtyre pasqyrave financiare. Menaxhimi pret që zhvlërësimi i aktiveve afatgjata materiale mund të ndikohet nga situata. Impakti financiar do të njihet nga Kompania gjatë vitit 2020. Menaxhimi do të vazhdojë të monitorojë ndikimin e mundshëm dhe do të ndërmarrë të gjitha hapat e mundshëm për të lehtësuar çdo efekt. Menaxhimi e konsideron këtë pandemi si një ngjarje që nuk rregullohet pas datës së raportimit dhe e ka shpallur në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare. Efektet mbi bazën e vijimësisë në përgatitjen e pasqyrave financiare janë shpallur në shënimin 4 "vlerësimet kritike të kontabilitetit" të këtyre pasqyrave financiare.

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së bilancit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.

mazars

Str. Emin Duraku,
B. "Binjaket" No. 5
Tirana, Albania

Tel: +355 4 2222 889
Tel: +355 4 2278 015
www.mazars.al